REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 137/17
Date/Datum. 11.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Zyrës së Prokurimit në Viti**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **657-17-1097-2-2-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtjen e varrezave te dëshmorëve, lumit dhe parqeve ne Viti**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Eco – Higjiena Sh.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Fehmi Agani, nr. 17
(Adresa)

Gjilan *(Vendi)*

60 000 *(Kodi postar)*

+377 45 435 755 *(Numri Telefonit)*

S'ka *(Numri i Faks-it)*

Eco – Higjiena Sh.P.K.
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

senad.ramaj@hotmail.com
(Adresa elektronike)

11 maj 2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftim per kontratë është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	✓				**Jo**		

Procesi i ecurisë së hapjes të tenderit për mendimin tonë, ka qenë një proces i rregulltë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po					**Jo**	✓	

Ne nuk e kemi pranuar njoftimin nga autoriteti kontraktues, por nga njoftimi për dhënie të kontratës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të KRPP-së, kemi kuptuar se jemi eleminuar nga tenderi, rrespektivisht se në lidhje me këtë tender është përzgjedhur një operator tjetër ekonomik me emrin QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. dhe jo ankuesi Eco – Higjiena Sh.P.K. Brenda afatit ligjor tek Autoriteti Kontraktues Zyra e Prokurimit në Viti, kemi parashtruar dy kërkesa: 1.) Kërkesën për rishqyrtim konform nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092; dhe 2.) Kërkesën për shikimin e dosjes të operatorit ekonomik fitues. 1.) Autoriteti Kontraktues me vendimin e tij me numër 02 – 013 / 485 të datës 2 maj 2017, e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, duke na dhënë 10 ditë afat për dorëzimin e ankesës në OSHP. 2.) Ndërsa në lidhje me kërkesën për shikimin e dosjes së OE fitues, AK-ja fillimisht e kishte miratuar kërkesën tonë, duke na ka caktuar terminin për shikimin e dosjes të OE fitues. Edhe pse ne në kohën e paparë kemi shkuar në zyrën e AK-së për shikimin e dosjes së OE fitues, megjithatë AK-ja nuk nuk na ka lejuar që ta shikojmë në tërësi dosjen e tenderit të OE fitues.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 65-71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Poashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 54 të Ligjit për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Operatori ekonomik fitues QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K., sipas regjistrit për biznese të Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë, është regjistruar në Agjensionin për biznese më datën 29.01.2016. Pretendimi i Autoriteti Kontraktues se Operatori Ekonomik fitues më herët ka vepruar me një numër tjetër biznesi dhe me numër tjetër fiskal, është plotësisht i gabuar, sepse sipas regjistrit të Agjensionit për Biznese, të cilat janë publike, QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. për herë të parë është themeluar në muajin Janar 2016 dhe jo më herët. Është e vërtetë se në Agjensionin për biznese janë të regjistruar dy biznese me emrin QENDRA KOPSHTARE N.P.SH. me mumër të biznesit 80112831 dhe QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. me numër të biznesit 71238121, por në këtë procedurë tenderuese ka aplikuar si biznes I vetëm vetëm QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K., e themeluar në vitin 2016.

2. QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional (Pika III.2.4 e njoftimit për kontratë), më konkretisht:

   a. Operatori Ekonomik fitues nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar për kontratat për shërbime të njëjta në tri vitet e fundit; dhe
   b. Operatori Ekonomik fitues nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuara për stafin e punëtorëve të punësuar në kompani, ku janë kërkuar së paku 20 të punësuar. Sipas shënimeve të Agjensionit për Biznese në Prishtinë, OE Fitues i ka të punësuar vetëm tre punëtor.

3. Operatori Ekonomik fitues objektivisht e kishte të pamundur që ta plotësonte kriterin e kërkuar për qarkullimin vjetor prej 100,000.00 Euro, për tre vite(për vitet 2014, 2015 dhe 2016), sepse sic e theksuam më lartë, OE fitues për herë të parë është themeluar në vitin 2016.

4. Operatori ekonomik fitues ka ofruar një tender të pazbatueshëm në kuptim të nenit 61 të LPP-së.

5. Autoriteti Kontraktues nuk na ka dërguar njoftimin për eleminim nga tenderi, por sic e kemi theksuar më lartë, në lidhje me elimimin e ankuesit, kemi kuptuar vetëm nga faqja zyrtare e KRPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmi real dhe fitimi i humbur i cili do të na shkaktohet si rrjedhojë e eliminimit të padrejtë dhe të kundërligjshëm i kompanisë sonë në këtë procedurë prokurimi, do të jetë shumë i madh dhe vështirë i rikuperueshëm.

Dëmi real: Ne kemi të punësuar disa punëtor të cilët vitet e kaluara i kanë kryer punët për shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtjen e varrezave te dëshmorëve, lumit dhe parqeve ne Viti. Për këta punëtor ne kemi paguar paga, tatime dhe kontribute dhe vlera total mujore është mijëra euro. Si rrjedhojë e eliminimit tonë të kundërligjshëm, neve jemi të detyruar që punëtorët të cilët kanë qenë të angazhuar në mirëmbajtjen shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtjen e varrezave te dëshmorëve, lumit dhe parqeve ne Viti, ose ti sistemojmë në vende tjera të punës ose ti ndërpresim kontratat e puëns për këta punëtor dhe kjo padyshim që do të ketë një kosto shumë të lartë.

Fitimi i munguar: Në lidhje me këtë projekt, gjatë përgatitjes së ofertës sonë për Autoritetin Kontraktues, ne kemi planifikuar edhe një fitim të caktuar dhe ky i fundit duke përzgjedhur pa të drejtë një kompani tjetër fituese dhe jo ankuesin, na ka privuar pa të drejtë nga ky fitimi I caktuar.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*